

# Buletini Tatimor

Kosovë • Korrik 2017



## Kontaktet:

Loreta Peçi

Partnere Menaxhuese

Shqipëri & Kosovë

E-mail: [loreta.peci@al.pwc.com](mailto:loreta.peci@al.pwc.com)

Gresë Rexhepi

Menaxhere

E-mail: [grese.rexhepi@al.pwc.com](mailto:grese.rexhepi@al.pwc.com)

Rr. Mujo Ulqinaku, No. 5,

Apt. 10, Kati 5

Qyteza Pejton

Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 722 555

[www.pwc.com/ks](http://www.pwc.com/ks)

## Zbatimi i rregullave të transferimit të çmimit

Në vijim të rishikimit dhe ndryshimit të versionit draft, Ministri i Financave ka nënshkruar [Udhëzimin Administrativ 2/2017 për Transferimin e Çmimit](#), i cili ka hyrë në fuqi më 28 Korrik 2017.

Qëllimi i këtij Udhëzimi është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për zbatimin e Nenit 27 (Transferimi i Çmimit) të Ligjit 05/L-029 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

### Çfarë është?

Transferimi i çmimit lidhet me të gjitha aspektet e marrëveshjeve të çmimeve mes entiteteve të lidhura. Rregullat e transferimit të çmimit janë krijuar për të parandaluar zhvendosjen e fitimit të kompanive shumëkombëshe nga vendet me norma tatimore më të larta në ato me norma tatimore më të ulëta apo zero. Ato përbëhen nga akte legjislative dhe udhëzime që ndihmojnë në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të tatimpaguesve të cilët marrin pjesë në transaksione të kontrolluara me palë të lidhura në juridiksionie të huaja tatimore.

Kohët e fundit politikat e transferimit të çmimit të kompanive shumëkombëshe kanë tërhequr vëmendje të shumtë, për shkak të rritjes së shpejtë të tregtisë ndërkombëtare, hapjes së shumë ekonomive në zhvillim dhe rritjes së ndikimit të transferimit të çmimeve në tatimin mbi të ardhurat e korporatave.

Rregullat e transferimit të çmimit të parapara në këtë Udhëzim në përgjithësi janë të bazuara në Udhëzimet e Transferimit të Çmimit për Ndërmarrje Shumëkombëshe dhe Administrata Tatimore të OECD-së, ndërsa kërkesat e dokumentacionit janë sipas kodit të BE-së për dokumentacionin e transferimit të çmimeve për ndërmarrje të lidhura në Bashkimin Evropian (2006/C 176/01).

## *Kur fillon?*

Këto rregulla dhe kërkesa do të jenë të zbatueshme për tatimpaguesit duke filluar nga *viti fiskal 2017*.

## *Kush ndikohet?*

Ky Udhëzim vlen për *tatimpaguesit kosovarë që paguajnë tatim mbi të ardhurat e korporatave, të cilët janë përfshirë në transaksione të kontrolluara me palë të lidhura që janë të vendosura në juridiksione të huaja tatimore.*

*Palë të lidhura* konsiderohen të jenë personat që kanë marrdhënie të veçanta dhe që mund të ndikojë materialisht në rezultatet ekonomike të transaksioneve mes tyre.

Shembuj të palëve të lidhura janë rastet kur:

- Një person mban ose kontrollon 50% ose më shumë të aksioneve apo të të drejtës së votës së kompanisë të personit tjetër;
- Një person direkt ose indirekt e kontrollon një person tjetër;
- Të dy personat janë direkt ose indirekt të kontrolluar nga një person i tretë;
- Personat janë të afërm të rradhës së parë, të dytë dhe të tretë të specifikuar sipas Ligjit mbi Trashigiminë të Kosovës.

*Personat e afërm familjarë* përfshijnë bashkëshortin, prindërit ose fëmijët.

Një person i lidhur konsiderohet se *kontrollon efektivisht vendimet e biznesit* të një personi tjetër nëse:

- mbajnë ose kontrollojnë 50% ose më shumë të të drejtave të votës të një personit tjetër, i cili është një person juridik;
- kontrollojnë përbërjen e bordit të drejtorëve të një personi tjetër, i cili është një person juridik;
- kanë të drejtën të shpërndajnë 50% ose më shumë të fitimeve të personit tjetër;
- personi tjetër është i afërm ose palë e lidhur me një të afërm;
- bazuar në fakte dhe rrethana të verifikuara, kontrollon vendimet e biznesit të personit tjetër.

Barra e provës për të vërtetuar 'kontrollin efektiv' i takon Administratës Tatimore të Kosovës ("ATK").

## *Çfarë do të thotë?*

*Transaksionet mes palëve të lidhura* që trajtohen me këtë Udhëzim përfshijnë *transaksione të kontrolluara mes rezidentëve të Kosovës* (duke përfshirë njësitë e përhershme të jo rezidentëve në Kosovë) dhe *jo rezidentëve*, si dhe *gjitha transaksionet mes rezidentëve të Kosovës* (duke përfshirë njësitë e përhershme të jo rezidentëve në Kosovë) dhe *rezidentëve të vendeve të caktuara me norma tatimore të ulëta apo zero*<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Andorra, Antigua & Bermuda, Antigua, Aruba, Bahamas, Bahrain, Barbados, Belize, Bermuda, Brunei, Costa Rica, Dominica, Fiji, Gibraltar, Grenada, Guadalupe, Guam, Guatemala, Guernsey, Guyana, Haiti, Hong Kong, British Virgin Islands, Cook Islands, Falkland Islands, Normand Islands, Solomon Islands, Turks and Caicos Islands, Christmas Island, Mariana Island, Marshall Island, US Virgin Island, Isle of Man, Jamaica, Jersey, Liberia, Liechtenstein, Macao, Madeira, Maldives, Martinique, Mauritius, Micronesia, Monaco, Montserrat, Nauru, Netherland Antilles, Niue, Oman, Palau, Panama, Philippine, Dominican Republic, Samoa, San Marino, Seychelles, St. Kitts and Nevis, St. Lucia, St. Vincent and Grenadines, Surinam, Tanzania, Tonga, Trinidad & Tobago, Tuvalu, Vanuatu.

*Natyra e transaksioneve të mbuluara përfshin mallra, shërbime, pasuri të paprekshme, transaksione financiare (p.sh. qira, hua, interesa, pagesat e garancive etj.), transaksione kapitale (blerja ose shitja e aksioneve apo instrumenteve tjera, duke përfshirë pasuritë afatgjata të prekshme dhe të paprekshme), etj.*

▶ *Vlera e hapur e tregut (për qëllime të transferimit të çmimit)*

Rregullat e transferimit të çmimit kërkojnë që transaksionet e kontrolluara të kryhen sipas *vlerës së hapur të tregut*, që do të thotë kompenzimi për çdo transaksionet brenda kompanive duhet të jetë në përputhje me vlerën që do të aplikohet nëse transaksioni ishte kryer mes palëve të pavarura, duke mbajtur të gjithë faktorët e tjerë të pandryshuar.

Edhe pse ky parim mund të duket i thjeshtë, përcaktimi i vlerës së kompenzimit është i mjaft i vështirë. Faktorë të rëndësishëm që ndikojnë përcaktimin e vlerës së kompenzimit përfshijnë llojin e transaksionit, si dhe rrethanat ekonomike që lidhen me transaksionin. Përveç ndikimit në shumën e kompensimit, këta faktorë mund të ndikojnë gjithashtu në formën e pagesës.

▶ *Krahasueshmëria*

Për të dëshmuar zbatimin e parimit të vlerës së hapur të tregut, transaksionet e kontrolluara duhet të krahasohen me *transaksione të krahasueshme të pakontrolluara* për të përcaktuar transferimin e çmimit. Këto transaksione të krahasueshme të pakontrolluara mund të jenë *të brendshme* (transaksione ku njëra palë është e kontrolluar dhe tjetra e pavarur) apo *të jashtme* (transaksione mes dy palëve të lidhura të pavarura).

Krahasueshmëria përcaktohet duke marrë në konsideratë disa faktorë, përfshirë këtu karakteristikat e pronës, mallit apo shërbimeve të transferuara, funksionet e marra përsipër, rreziqet e përfshira, pasuritë dhe kapitali i përdorur nga secila palë, kushtet kontraktuale, rrethanat ekonomike dhe strategjitë e biznesit.

ATK mund të përdorë transaksione të pakontrolluara me qëllim të rregullimit të transferimit të çmimit të tatimpaguesit, por vetëm nëse transaksione të tilla nuk përmbajnë informacion konfidencial dhe burime tjera të informacionit janë të disponueshme për ato transaksione.

Në mungesë të transaksioneve vendore të krahasueshme, ATK lejon përdorimin e transaksioneve të huaja të krahasueshme, me kusht që tatimpaguesi që bën rregullimin e krahasueshmërisë (nëse duhet) të analizojë diferencat gjeografike dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në treguesit e përdorur financiarë.

Në rastet kur informacioni mbi transaksione të krahasueshme nuk është i disponueshëm për të njëjtën periudhë tatimore në të cilën kryhet transaksioni i kontrolluar, tatimpaguesit mund të përdorin informacionin për periudhën më të fundit në dispozicion.

▶ *Metodat e transferimit të çmimit*

Sipas udhëzimeve të OECD-së, ky Udhëzim njuh metodat e mëposhtme të transferimit të çmimit:

### 1. *Metoda e çmimit të krahasueshëm të pakontrolluar*

Metoda e çmimit të krahasueshëm të pakontrolluar krahason çmimin e pronës apo shërbimeve të transferuara në një transaksion të kontrolluar me çmimin e pronës apo shërbimeve të transferuara në një transaksion të krahasueshëm të pakontrolluar në rrethana të krahasueshme. Çmimi është treguesi financiar i duhur për zbatimin e kësaj metode.

### 2. *Metoda e çmimit të rishitjes (R-)*

Metoda e çmimit të rishitjes e krahason çmimin e shitjes të një produkti që blihet nga një ndërmarrje e lidhur dhe që shitet tek një palë e pavarur, duke e zvogëluar atë me marzhin e çmimit të rishitjes (shuma e cila i mundëson rishitësit t'i mbulojë shpenzimet e shitjes dhe shpenzime tjera operative dhe si pasojë e funksioneve të kryera, të nxjerrë një fitim të mjaftueshëm). Marzhi i çmimit të rishitjes është treguesi financiar i duhur për zbatimin e kësaj metode.

### 3. *Metoda kosto plus (C+)*

Metoda kosto plus merr parasysh kostot (direkte dhe indirekte) që i bartë furnitori i pronës apo shërbimeve në një transaksion të kontrolluar dhe i shton marzhën për të arritur një fitim sipas funksioneve të kryera (duke llogaritur asetet e përdorura dhe riskun e përfshirë) dhe kushteve të tregut. Marzhi i koston plus është treguesi financiar i duhur për zbatimin e kësaj metode.

Kur metodat tradicionale të mësipërme nuk mund të aplikohen, atëherë mund të përdoren metodat e transaksioneve si më poshtë:

### 4. *Metoda e marzhit neto të transaksionit*

Metoda e marzhit neto të transaksionit e krahason marzhin neto të fitimit ndaj një baze të përshtatshme (p.sh. kostot, shitjet, asetet) që një tatimpagues arrin në një transaksion të kontrolluar, dhe e krahason me një transaksion të pakontrolluar. Ka disa tregues financiarë që mund të përdoren për zbatimin e kësaj metode.

### 5. *Metoda e ndarjes së fitimit*

Metoda e ndarjes së fitimit identifikon fitimin e kombinuar që do të ndahet mes ndërmarrjeve të lidhura nga një transaksion i kontrolluar dhe pastaj i ndan ato fitime mes ndërmarrjeve të lidhura bazuar në një bazë të vlefshme ekonomikisht e cila përafron ndarjen e fitimeve që do të ishin parashikuar dhe reflektuar nga një marrëveshje e bërë me vlerën e tregut.

Kur metodat tradicionale nuk mund të përdoren, duhet të konsiderohen metodat e transaksioneve të rradhitura më lartë, por në cilindo rast, përparësitë, dobësitë, përshtatshmëria, disponueshmëria e informacionit, dhe shkalla e krahasueshmërisë duhet të merren parasysh gjatë zgjedhjes së metodës që do zbatohet për transferimin e çmimit. Edhe pse kërkohet që vetëm një metodë të përdoret, tatimpaguesit mund të përdorin metoda shtesë apo një kombinim të tyre për të mbështetur transferimin e çmimit.

► *Shërbimet brenda grupit me vlerë të ulët të shtuar*

Shërbimet brenda grupit me vlerë të ulët të shtuar janë shërbime të kryera nga një apo më shumë anëtarë të grupit të kompanisë shumëkombëshe në emër të një ose më shumë anëtarëve tjerë të grupit.

Këto shërbime janë të natyrës mbështetëse (nuk janë pjesë e biznesit bazë të grupit të kompanisë shumëkombëshe); nuk kërkojnë përdorimin e pasurisë së paprekshme të veçantë dhe të vlefshme (dhe nuk çojnë në krijimin e tyre); dhe nuk përfshijnë (ose nuk çojnë në) rrezik të konsiderueshëm për ofruesin e shërbimit.

Një qasje e thjeshtësuar për përcaktimin e vlerës së tregut përdoret në raste të tilla për të zvogëluar koston e përmbushjes tatimore të tatimpaguesve dhe për të ofruar siguri më të madhe për ndërmarrjet shumëkombëshe kur u ofrojnë shërbime të tilla anëtarëve të grupit të tyre. Kjo qasje përfshin llogaritjen, në baza vjetore, të kostove totale të të gjithë anëtarëve të grupit për shërbimet me vlerë të ulët të shtuar në grup, duke identifikuar dhe përjashtuar kostot dhe shpenzimet direkte që i atribuohen disa anëtarëve, dhe duke i shpërndarë këto kosto midis anëtarëve bazuar në zbatimin e shpërndarjes kyçe.

Për shërbime të tilla, nuk ka nevojë të përgatitet një studim i transferimit të çmimit, por lejohet një *marzhë e fitimit mbi kosto në maksimum prej 7%*. Nëse ky prag tejkalohet, ATK mund të mos e pranojë atë dhe mund të kërkojë një analizë të plotë për të mbështetur marzhën e aplikuar.

Pavarësisht nga më sipër, ATK mund të kërkojë informacion dhe dokumentacion shtesë mbi shërbimet e tilla, duke përfshirë një përshkrim të shërbimeve të ofruara/ pranuar, entitetet përfituese, arsyetimin ekonomik, shpërndarjen e kostove, kontratat, llogaritjet dhe dokumentimin e kostove, etj.

► *Rregullimet e ATK-së*

ATK mund të bëjë rregullime të çmimeve të ngarkuara nga një tatimpagues në transaksione të kontrolluara vetëm me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm. Kur treguesit financiarë që përdoren janë jashtë vlerës së tregut, ATK do të përdorë medianën e gamës së tregut, përveçse kur ATK-ja ose tatimpaguesi dëshmon se vlera e tregut nuk është mediana por një vlerë tjetër në atë gamë.

Kur nuk ka informacion të mjaftueshëm për qëllime të krahasimit, ATK mund të përdorë vargun kuartil në vend të vlerës së tregut.

Rregullimet përkatëse mund të bëhen nëse Kosova dhe vendi në fjalë kanë marrëveshje për eliminimin e tatimit të dyfishtë. Tatimpaguesit mund të kërkojnë nga ATK të bëjë rregullimet përkatëse, ku kjo e fundit do të përgjigjet brenda 3 muajve duke i njoftuar ata nëse kërkesa e tyre miratohet apo refuzohet (pjesërisht apo tërësisht).

## *Si përmbushen këto kërkesa?*

*Tatimpaguesit e përfshirë në transaksione të kontrolluara mbi 300,000 Euro ose më shumë gjatë një viti kalendarik janë të detyruar të:*

1. *Përgatisin dokumentacionin e transferimit të çmimit sipas Kodit të Sjelljes mbi Dokumentacionin e Transferimit të Çmimit për Ndërmarrje të Lidhura në Bashkimin Europian (2006/C176/01).*

- *Përditësojnë treguesit financiarë të transaksioneve të krahasueshme të pakontrolluara çdo vit.*
- *Përditësojnë kërkimet në databazë për transaksionet e jashtme të krahasueshme çdo tre vite (përpos në rastet kur ka pasur ndryshime të mëdha).*

2. Dorëzojnë një *Njoftim Vjetor të Transaksioneve të Kontrolluara* në ATK deri më 31 Mars të vitit të ardhshëm, së bashku me pasqyrat financiare dhe deklaratën e tatimit mbi të ardhurat e korporatave.

*Dokumentacioni i transferimit të çmimit* duhet të përmbajë së paku:

- Përmbledhjen e aktiviteteve të tatimpaguesit dhe strukturës organizative;
- Analizën e krahasueshmërisë, duke përfshirë:
  - Karakteristikat e pronës dhe shërbimeve;
  - Analizën funksionale (funksionet e kryera, asetet e përdorura, rreziku i marrë përsipër);
  - Kushtet kontraktuale;
  - Rrethanat ekonomike;
  - Informacionin përkatës mbi transaksionet e krahasueshme të pakontrolluara (të brendshme/të jashtme) – duke përfshirë çdo veprim rregullues të krahasueshmërisë
- Arsyetimin për zgjedhjen e një metode të transferimit të çmimit dhe treguesit financiar;
- Çdo informacion tjetër që mund të jetë i nevojshëm në vërtetimin e aplikimit të vlerës së tregut.

Barra e tatimpaguesit në lidhje me transferimin e çmimit përfundon kur dokumentacioni përgatitet sipas Kodit të mësipërm. Megjithatë, ATK mund të bëjë rregullime të transaksioneve të kontrolluara edhe përkundër mungesës së dokumentacionit.

Dokumentacioni ose dosja e transferimit të çmimit mund të dorëzohen në njërin nga gjuhët zyrtare (Shqip ose Serbisht), si dhe në gjuhën Angleze në rrethana të veçanta dhe me marrëveshje paraprake me ATK-në. Dosja duhet t'i vihet në dispozicion ATK-së brenda 30 ditëve nga data e kërkesës së tyre, dhe dështimi për ta përgatitur dhe dorëzuar dokumentacionin në kohë mund të rezultojë në gjoba administrative deri në 2,500 Euro.

Për tatimpaguesit që kryejnë transaksione të kontrolluara në vlerë prej 300,000 Euro apo më pak në një vit kalendarik, kërksat e mësipërme vlejné me përjashtim të a) dorëzimit të Njoftimit Vjetor të Transaksioneve të Kontrolluara (nuk kërkohet); dhe b) përditësimin të treguesve financiarë të transaksioneve të krahasueshme të pakontrolluara (kërkohet çdo tre vite).

### *Si mund të më ndihmojë PwC?*

Me mbi 3,100 profesionistë në mbi 93 shtete, praktika e PwC-së në fushën e transferimit e çmimit është e duhura t'ju këshillojë për strategji që mund të ndihmojnë në arritjen e qëllimeve tuaja në një ambient shumë të ndryshueshëm tatimor.



[PwC Kosovo](#) shfrytëzon njohurinë dhe përvojën e saj vendore në fushën tatimore së bashku me ekspertizën dhe referencat e transferimit të çmimit në rajon dhe botë, për t'i ofruar klientëve shërbime të plota të transferimit të çmimit, përvojën e specializuar në industrinë e shërbimeve financiare, si dhe zgjidhje për përmbushje tatimore të transferimit të çmimeve në shumë industri.

Mësoni më shumë për transferimin e çmimit dhe PwC-në duke parë [International Transfer Pricing 2015/16 guide](#) dhe [TP Talks podcast series](#).

Për informacion të detajuar në lidhje me këtë ndryshim ligjor dhe se si PwC mund t'ju ndihmojë në përmbushjen e kërkesave të transferimit të çmimit në Kosovë, ju lutem [na kontaktoni](#) për të diskutuar më shumë.

*[Burimet: Udhëzimi Administrativ Nr. 2/2017 për Transferimin e Çmimit; Ligji 05/L-029 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave; Ligji 03/L-222 i ndryshuar për Administratën Tatimore dhe Procedurat]*

Ky Buletin Tatimor është përgatitur nga PwC Kosovo, Departamenti i Tatimeve dhe Shërbimeve Ligjore.

Vërejtje ligjore: Materiali i përfshirë në këtë publikim shërben vetëm për qëllime të informacionit të përgjithshëm dhe nuk përmban një analizë të plotë të elementeve të përshkruara. Para marrjes (apo mos marrjes) të ndonjë veprimi, çdo lexues duhet të kërkojë këshilla profesionale specifike për situatën e tyre. Asnjë përgjegjësi nuk pranohet për veprimet ose mosveprimet e ndërmarra në mbështetje të përmbajtjes së këtij publikimi.

Tek PwC, qëllimi jonë është që të fitojmë besimin në shoqëri dhe të zgjidhim probleme të rëndësishme. Ne jemi një rrejt kompanish në 157 vende me më shumë se 223,000 njerëz të cilët janë të përkushtuar në ofrimin e shërbimeve cilësore të auditimit, tatimeve dhe këshillave. Informohuni dhe na tregoni se çfarë është me rëndësi për ju tek [www.pwc.com](http://www.pwc.com) PwC i referohet rrjetit të PwC dhe/ose një apo më shumë anëtarëve të tij, ku secili është një entitet i ndarë ligjor. Ju lutem shihni [www.pwc.com/structure](http://www.pwc.com/structure) për më shumë detaje. ©2017 PwC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.